

BIBLIOTEKA

E

8JH-1

K 14.

GJIROKASTER

SHTELLI

BIBLIOTEKA E NXENESIT

ISMAIL KADARE

P O E Z I

891.983 - 1

8JH-1  
K14

ISMAIL KADARE

# Poezi

335556

*Përgatitur për botim nga  
Luan Rexhepi dhe  
Bahri Nelaj*

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR

ISMAIL KADARE

9941  
151

# Poëzi

poemët e poetët  
poemët e poetët  
poemët e poetët

Redaktor: L. Rexhepi

Korrektor letrar: A. Jupi

## POEZI E PARTISHME, MILITANTE DHE QYTETARE

Poezia jonë e realizmit socialist doli nga lufta partizane me një pasuri dhe me një traditë jo të paktë dhe me autorë të njojur, si: Shevqet Musaraj, Lazar Siliqi, Kolë Jakova, Fatmir Gjata, Andrea Varfi etj., që u bënë shembull për edukimin e brezave letrarë poetikë që do të vinin më vonë. Poezia e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare u dha po- eteve të rinj jo vetëm lëndë, por dhe forca të reja për krijim. Ajo u tregoi se vargjet, kënga mund të shkruhen kudo, ku ka jetë dhe luftë. Përveç kësaj, letërsia jonë futej në gjysmën e dytë të shekullit XX me një bagazh të pasur poetik. Ajo vinte me Naimin, bilbilin dhe këngëtarin e madh të Shqipërisë, me De Radën, romantik përparimtar dhe atdhetar i flaktë, që përdori i pari poemën, me Mjedën, mjeshtër të vargut muzikor, me Çajupin patriot, satirëtherës, me Migjenin, këngëtar i revoltave shoqërore etj.

Kjo traditë kaq e pasur nuk kishte as më të voglin dyshim që do të luante një rol të madh në edukimin e poetëve të rinj. Ndërkaq, revolucioni ynë popullor me fitoret e pandërprera që korrte po bëhej qdo ditë e më tepër fryshtim i një brezi të ardhshëm poetësh, që i filluan ligjërimet e para poetike rrëth viteve '50. Ndonëse ende të rinj, te këta poetë spikati qysh në fillim dëshira dhe vullneti për të rrahur në poezinë e tyre tema të rëndësi-shme dhe probleme të mprehta. Nga këto fillime poetike ne jemi në gjendje të përcaktojmë saktë rrugën që ata morën si poetë këngëtarë të jetës së re që solli liria. Krahas luftës për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, pjestarë të së cilës ishin dhe këta të rinj, disa prej tyre nxënës shkollash dhe më vonë poetë të shquar të Shqipërisë socialiste, Partia hodhi parrullën për edukimin e njeriut tonë të ri, nxori detyra për letërsinë dhe artet, që ato të ishin në gjendje t'i përgjigjeshin dhe të pasqyronin vrullin e masave për ndërtimin e Shqipërisë së re. Ndër këta nxënës të rinj, tanë poetë të njohur, që krijimet e para ia drejtonin gazetës «Zeri i Rinisë» dhe «Drita», shquheshin: Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Fatos Arapi etj.

Ismail Kadare i takon brezit të poetëve që bënë përpjekjet e para për të shprehur edhe nga ana e formës artistike hovet e reja që kish marrë dhe po merrtejeta jonë e re socialistë. Që në fillim ne shohim te poeti i ri, Ismail Kadare, një prirje për një poezi qytetare, poezi militante me përbajtje të thellë socialistë. Kjo është edhe arsyja që poezitë e këtij autori, megjithëse kanë rrëth njëzet-tridhjet vjet që janë botuar, ruajnë

freskinë dhe aktualitetin edhe në ditët tona. Nuk ka vlerësim më të madh për një vepër arti, kur ajo i bën ballë kohës dhe historisë. Po të kujtojmë poemën e njojur «Përse mendohen këto male» ne bindemi menjëherë se ajo jo vetëm ka luajtur një rol të madh për edukimin ideoartistik të brezave të rindë, por dhe do ta luajë atë dhe në të ardhmen. Kjo gjë flet më së miri për suksesin e poezisë së Ismail Kadaresë. Kudo që të shikosh vëllimet e botuara nga poeti e gjejmë një gjë të tillë. Shpjegimi i këtij suksesi gjendet në atë cilësi të poezisë së tij, që ajo rrok hove të mëdha, përshkohet nga një tendenciozitet i thellë klasor, që flasin qartë për bindjet poetike të autorit.

Në përgjithësi poezia e autorit sjell gjithmonë diçka të re, në mënyrë të veçantë në sferën e poezisë qytetare me përbajtje të theksuar politike. Këtë poeti e ka bërë mishin dhe gjakun e gjithë veprës së tij letrare, madje dhe temat intime e ato shoqëroret janë shpesh të gëreshetuara me probleme politike. Autorin gjithnjë e kanë rrëmbyer temat madhore qofshin të marra nga historia, qofshin nga jeta për ndërtimin e socialistizmit. Të gjitha këto ai i ka trajtuar me syrin e shkrimitarit militant, të qytetarit të ndershëm që nuk e ze gjumi për fatet e atdheut dhe të revolucionit.

Problematika e pasur e poezisë së I. Kadaresë e bën këtë poezi që ajo t'u qëndrojë kohës dhe kërkesave të poezisë së sotme të realizmit socialist. Ajo i ngjan një fushe të gjerë, mbushur me lule nga të gjitha llojet, siç është vetë jeta jonë sociale. Nuk ka dukuri shoqërore që të mos bëhet

pjesë e kësaj poezie, ajo është e ndjeshme ndaj çdo shfaqjeje e problematike shoqërore.

Në themel të kësaj poezie është lufta dhe puna e popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e jetës së re socialiste. Ajo sjell vrullin revolucionar të masave në këtë luftë heroike të popullit dhe të Partisë sonë, që në kushtet e bllokadës së egër imperialiste e revisioniste po çajnjë gjithmonë përpëra, duke u mbështetur fuqimisht në forcat tona. Poezia e tij është e ndjeshme ndaj të gjitha përparimeve në fushën e industrializimit socialist të vendit. Le të kujtojmë këtu poemën «*Endërr industriale*». Poetit i ngrohet zemra dhe i bëhet mal kur sheh se njeriu ynë i ri është hedhur në këtë aksion ndërtimitar dhe rritet, kalitet dhe edukohet nga dita në ditë në luftë dhe në punë. Poezia e tij bëhet gjithnjë më e fortë dhe më shprehëse, kur poeti pasqyron vrullin revolucionar dhe heroizmin e këtij njeriu, që është vepra më e mrekullueshme e Partisë sonë të lavdishme.

Tema më e dashur për poetin ka qenë dhe mbetet tema e madhe e qëndresës së *popullit tonë* në *shekuj* dhe *në epokën e ndritur* të PPSH. Lufta e madhe që bën PPSH dhe gjithë populli ynë kundër revisionizmit dhe imperializmit është, gjithashstu, një nga temat më të parapëlqyera të këtij autori (le të kujtojmë romanin «*Dimri i madh*» etj.).

Një veçori dalluese e poetit është puna këmbëngulëse në kërkim të vargut dhe të mjeteve shprehëse poetike.

Qysh në moshën 19 vjeçare poeti botoi vëllimin e parë poetik «*Endërrimet djaloshare*». Në këtë vëllim vjen e freskët atmosfera e hareshme

dhe optimiste që karakterizonte rininë tonë, që ish hedhur në aksione madhështore, të cilët do t'ia ndryshonin faqen atdheut. Lirizmi plot dritë dhe frymëzimi i vëtëvetishëm e i ndërgjegjshëm ishin karakteristikat e vjershave të para të këtij vëllimi. Ky libër me të drejtë tërroqi vemendjen e lexuesve dhe të kritikës, sepse sillte mbresa të freskëta nga jeta, kishte një figuracion të pasur. Te ky shkrimtar i ri shohim edhe punën e madhe këmbëngulëse për të njohur e studiuar tërë traditën tonë poetike, në mënyrë të veçantë poetët e mëdhenj: Naimin, De Radën, Mqedën, Migjenin etj. Te kjo traditë e pasur poeti gjeti dhe stilin e tij poetik që do të shkëlqejë më vonë me një individualizëm të veçantë. Dy vjet më vonë u botua vëllimi «Endërrimet» që për nga tematika nuk ndryshon shumë nga i pari dhe mund të cilësohej si një vazhdim i tij. Ajo që spikat në këtë vëllim është rritja e nivelit dhe të pjekurisë artistike. Tani kemi të bëjmë me poetin që punon me ngulm për formimin dhe kristalizimin e individualitetit të tij artistik dhe që shkëputet nga ndonjë ndikim i poetëve të tjera. Në këtë vëllim dalin të kristalizuara qart dhe pastër, endërrat e brezit të ri, romantizmi rinnor, optimizmi dhe hovj revolucionar i rinisë sonë për ta bërë atdheun më të bukur e më të lulëzuar. Këtu kemi të bëjmë me një diapazon më të gjërë poetik e problematik. Heroïn lirik të këtij vëllimi e gjejmë kudo, por të ndryshuar e të burrëruar, ai është bërë më qytetar, më i thellë në vështrimin e jetës dhe të kërkesave ndaj saj. Kështu, fillojnë e marrin udhë temat e mëdha. Tani kemi të bëjmë jo më me një djalosh që ka dëshirë të

skicojë e të bëjë konture të përgjithshme poetike, por me një poet të pjekur, që fillon të zgjerojë gamën tematike; gjithashtu, fillon të thellojë përmbytjen e krijimeve të tij. Dhe këtë formim ai e arriti duke u shkrirë e bërë njësh me jetën socialistë, që bëhej më e bukur nga dita në ditë.

Procesi i formimit poetik i Ismail Kadaresë nuk deshi ndonjë kohë shumë të gjatë. Këtë, poeti e arriti shumë shpejt në sajë të një pune të madhe dhe të kujdeshshme. Botimi i vëllimit poetik «*Shekulli im*» shënoi një etapë krejtësisht të re në tërë krijimtarinë e tij. Këtu kemi të bëjmë me poetin e ri, që e thotë hapur e pa ndrojtje fjalën e tij, i cili këndon si këngëtar që i ka kaluar provat e vështira; ai tani është i sigurt për çka shkruan, por ndjen dhe kënaqësinë e veçorive novatore, që po sillte me vete poezia e tij. Pas këtij formimi të individualitetit të tij poetik I. Kadare na jep vëllime të tjera poetike, si: 'Përse mendohen këto male' (1964), «Motive me diell» (1968) dhe «Koha» (1976), ku janë përbledhur dhe mjaft poema të reja. Po kësaj periudhe i përkasin edhe botimet e romaneve, tashmë të njojur, si: «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Dasma», «Kështjella», «Kronikë në gur», «Dimri i madh», «Nëntori i një kryeqyteti», vëllimet me novela «Emblema e dikurshme», «Ura me tri harqe», «Gjakftohtësia», librat me esé «Autobiografia e popullit në vargje» dhe tani së fundi romani «Gjakftohtësia». Tek e sheh këtë prodhimtari mëndja menjëherë të vete te puna e madhe e këmbëngulëse që bën ai. Bindesh se talenti nuk është vetëm një dhundi natyrore, dhe nuk lulëzon kurrë pa një punë këmbëngulëse.

Vëllimet poetike që u botuan në vitet '60 e këtëj shquhen në shumë drejtëime si nga ana e mjeshtërisë poetike, ashtu dhe nga tematika e gjerë. Në to ne gjejmë ndonjëherë dhe temat e prozës së tij, gjë që tregon se poeti gjithnjë rrëmon në atë që ka krijuar, në atë që ka thënë, duke na i dhënë në një mënyrë krejt të re, dëshmi kjo e talentit të tij. Ato me një vështrim të vëmendshëm të krijojnë poemën e madhe epike të qëndresës së popullit tonë. Poezia e këtyre vëllimeve vjen e freskët dhe e begatë në figuracion. Ato tregojnë se poeti është me të vërtetë mjeshtër i metaforave, i krahasimeve, i simboleve dhe i figurave të tjera artistike. Në to gjejmë jetën e gjallë të popullit tonë ndër shekuj. Kjo jetë na vjen e virgjër, luftarakë e dinamike, siç ka qenë dhe siç është në të vërtetë. Tonet epike gërshtohen në mënyrë orijinale dhë organike me hovet lirike edhe të vetë heroit lirik. Vëllimi «Përse mendohen këto male» dhe «Motive me diell» sjellin të lexuesi erën e bërrutit dhe të djersës që e vaditën dhe e vaditin tokën tonë. Para nesh poeti sjell historinë edhe qëndressën në çaste kyçë përfatet e popullit. Këto çaste qëndrojnë si copa graniti në ndërtësën e madhe poetike të I. Kadaresë. Në këto vëllime spikat qartësia politike, botëkuptimi revolucionar marksist-leninist, që është gërshtuar dhe me talentin dhë mjeshterinë poetike të autorit.

Duke u futur shtigjeve të reja poetike, duke kërkuar si novator i vërtetë, brenda traditës sonë poetike, ai pasuroi gjuhën e poeziës dhe konsolidoi individualitetin e tij artistik. E rëndësishme në poezinë e tij është se poëti kap atë që është e re

dhe përparimtare në shoqérinë tonë, duke ia nënshtruar një përparimi me shije të lartë artistike. Ai ka ditur të plotësojë kërkesat e kohës për një poezi militante me fryshtë e tingëllime aktuale, kombëtare e populllore. Ai nuk është kapur pas vögëlsirave, por pas temës së madhe. Në këto dy vëllime gjejmë dhe dy nga poemat më të mirat e poetit dhe të tërë poezisë sonë të realizmit socialist: «*Shqiponjat fluturojnë lart*» dhe «*Përse mendohen këto male*». Te poema «Përse mendohen këto male» rriven problemet e mëdha të kohës dhe zbulohen, me një ngjyrë të veçantë poetike, thelbi i ngjarjeve të rëndëfishme që përshkonin jetën e vendit, entuziazmin dhe optimizmin patriotik revolucionar të popullit tonë, besimi i patundur që njerëzit tanë shfaqën përballë vështirësive të reja, që erdhën si rezultat i tradhëtisë së revolucionit dhe socializmit nga Bashkimi Sovjetik, si dhe i presioneve dhe bllokadës ndaj vendit tonë. Nëpëmjet simboleve dhe metaforave ai nxjerr në pah papërkulshmërinë e popullit tonë në këto tallaze e tramundana të kohës. Ndërsa poema «*Shqiponjat fluturojnë lart*» i kushtohet arkitektës së jetës sonë, Partisë së Punës. Ideja se formimi i Partisë ishte një domosdoshmëri objektive, që buronte nga realiteti ynë del e plotë dhe e qartë. Krijimi i Partisë ishte fryt i pjekjes së tërë kushteve historiko-shoqërore të vendit për të gjetur rrugën e lirisë, dhe të jetës së lumtur. Figura e Partisë shfaqet në Poemë në lidhje të ngushtë me fatet e vendit dhe të popullit. Përsiatjet mbi të kaluarën historike të vendit tonë e bënë poetin të hyjë thellë në indet e historisë dhe kështu, ai arriti ta japë krijimin

e Partisë si një domosdoshmëri historike. Vetë tulli i poemës është më se domethënës: *Shqiponjat do të fluturojnë gjithnjë lart në qellin e Shqipërisë socialiste, se kanë Partinë shqipe të sprovuar në tallaze e furtuna.*

Te «Motivet me diell» spikat dhe lufta kundër revizionizmit nëpërmjet poeziës së bukur «*Kali i Trojës*». Krahasimi i revizionizmit me «kalin e drunjtë», si simbol i tradhëtisë, u përshtatet plotësisht tradhëtarëve të çështjes së socializmit. Te kjo poezi ne gjejmë dhe frymën internasionaliste që karakterizon në përgjithësi poezinë e Ismail Kadaresë. Poeti shpreh ndjenjat dhe mendimet e tërë popullit të tij, kur shprehet se popujt duhet të ruhen nga «*Kali i Trojës*», dhe duhet të rrinë gjithnjë zgjuar.

Po në këtë vëllim shohim të rrihen dhe motive që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit në rrugën e socializmit, në të materializohen vendimet e Partisë, si p.sh. në poezinë «*Fjalim para tokave të reja*» apo «*Motive për elektrifikimin e përgjithshëm të Shqipërisë*». Autori nuk qëndron indiferent dhe ndaj problemeve shoqërore, në mënyrë të veçantë objekt i poeziës së tij bëhen lufta që bën populli dhe Partia kundër zakoneve prapanike.

Heroizmi masiv i popullit tonë dhe i masave tona punonjëse ze vendin kryesor në tërë poezinë e autorit. Këtë heroizëm poeti e jep në kuptimin thallisht revolucionar të këtij tipari dallues të moralit të njerëzve tanë, që çdo gjë ia kushtojnë çështjes së Partisë dhe të socializmit. E tillë është poezia e bukur kushtuar fillërojtësit Ndue Llesh De-

da që ra heroikisht në krye të detyrës për të sigruar ndërlidhjen mes krahinave të Shqipërisë, apo akti heroik i aviatorit Niko Hoxha. Në këto dhe në të tjera del qartë se njeriu ynë i ri, ndertues i socializmit, është i aftë të çojë vendin më përpara për të mbrojtur fitoret që ka arritur.

Pas një pushimi gati prej tetë vjetësh, për arsyen e angazhimit në gjininë e prozës, poeti i dha lexuesit vëllimin e ri me titull «Koha». Te ky vëllim poetik, që i kushtohet kryesisht kohës sonë, shquhet puna këmbëngulëse për të depërtuar në thelb të proceseve shoqërore, në periudhat kyçe e të mëdha historike, qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare. Nga ky depërtim në jetë dhe në histori poeti del me një mendim filozofik të pjekur dhe përparimtar e luftarak, duke afirmuar të renë revolucionare e socialiste. Duke pasur parasysh këto të vërteta e fakte historike, në vargjet e tij, si n'ëpër damarët e vëtë historisë dhe të jetës vërshon i pandalshëm vrulli i kohrave shqipëtare, ecja plot vrull dhe dinamizëm përpara drejt majave më të larta të zhvillimit në vendin tonë. Në poezi vërshojnë si mendimi i gjallë e revolucionar, ashtu dhe ndjenjat e bukura e të pastra, që lindin bashkë me botën e re.

Koha nuk i intereson poetit vetëm si nocion filozofik, por si nocion që lidhet ngushtë me faktet e atdheut të tij, me të shkuarën dhe të ardhmen. Edhe te ky vëllim spikat patosi i papërkulshëmërisë dhe i qëndresës heroike të popullit tonë. Kjo vëçori përbën dhe indin kryesor të tërë poezisë së poëtit.

Problemet e mprehta që duken në jetë poeti

i kap dhe i trajton të kapura me syrin e së sotmes dhe të së ardhmes. Të tilla janë problemet e luftës kundër shfaqjeve të huaja dhe detyrat që nxori Plenumi IV i KQ të PPSH i vitit 1973 për luftën kundër tyre. Poezi të tilla, si: «Mësueset e fshatit» dhe «Shpjegim për librat e Besianës së vogël», «Lulemollët» e shumë të tjera, tregojnë përmprehësinë e penës së poetit.

Edhe ky vëllim, si të tjerët shquhet përmënjë figuracion të guximshëm poetik. Arti i tij është një art realist, që mbështetet në parimet themelore të realizmit socialist. Poezia e tij është e fortë, aq sa e bukur dhe lirike, aq edhe e mprehtë politike, me proporcione të mëdha mendimesh e idesh. Ajo shquhet përmënjë artin e gdhendur dhe harmonik, pak i rreptë dhe epik, si vetë temat që trajtohen.

Në këtë vëllim janë zgjedhur një pjesë e vogël nga krijimtaria e poetit me qëllim që ato t'i shërbejnë nxënësit, nga njëra anë si shembuj të rrugës poetike të autorit dhe, nga ana tjetër, si një ndihmë dhe përvojë poetike në rrugën e krijuesve të rinj letrarë, që dalin nga të gjitha sferrat e jetës sonë dhe nga gjiri i rinisë sonë shkollorë.

## PARTIA IME

Atë që dot s'ma jepte kush,  
Partia ime, ti ma dhe.

Nj'armatë shokësh sup më sup,  
më madhështoren përmbi dhe.

Me mijëra zemra që janë lidhur,  
si enë komunikuese varg.

Në dejtë e mi me anë të tyre,  
sec rrjedh ky gjaku yt i madh.

Dhe ja, po ndiej si gjaku yt,  
me puls të njëjtë rreh në damarë.  
Që nga m'i thjeshti komunist,  
e gjer te Sekretari' i Parë.

Të vjetrit shpesh hyjnëtë i kanë  
me shumë flatra, sy e vesh.  
Unë qesh me perënditë indiane,  
me perënditë greke qesh.

Me sistem zemrash lidhur bashkë,  
që ti, Partia jonë, na dhe.

M'i thjeshti komunist në radhë,  
ngrihet mbi qindra Promete.

Se s'ka më mrekulli të madhe  
që në komunë kështu të jesh,  
Që në trup tënd gëzim e halle,  
të mijëra shokëve të kesh.

Të ngjitet nga pünëtori i vjetër,  
te burri i shtetit një merak  
ose të zbresë nga burri i shtetit,  
qederi i madh te bujku plak.

Dhe mua gjumi mos më marrë  
për farën që në fushë s'mbiu.  
Për librin tim të keq fshatari  
të kthehet njëzet herë në brinjë.

Të ndiesh Parti, si gjaku yt  
me puls të njëjtë rreh në damarë.  
Që nga m'i thjeshti komunist  
e gjer te Sekretar i Parë.

Unë qesh me perënditë indianë,  
me perënditë greke qesh.  
Me ty unë jam i lartë si malet,  
pa ty, në çast si gogla vdes.

Me ty dhe dhembja më e thekshme  
ka vlerë më shumë se një gëzim.  
Me ty do t'isha i pavdekshëm  
dhe sikur t'isha anonim.

## **STATUJA PA KRAHE...**

1.

Nga thellësitë e tokës u nxorën statujat.  
Statuja të bardha,  
në shekullin I  
të groposura,  
nga duart vigane të kohërave  
të varrosura.  
Statujat shkundën pluhurin nga supet e mermerta,  
me sy të çuditur, të përgjumur,  
sikur thoshin:  
— Sa kemi fjetur!  
Sikur pyesnin:  
— Ku jemi?  
Sikur u përgjigjeshin:  
— Në shekullin **XX**

2.

Nga thellësitë e tokës u nxorën statujat.  
Një luftë e tmerrshme i përbysit me rrëmujë,  
dikur, në shekullin I,  
dhe koha me pluhur ua mbuloi varrë.  
Statuja të ngritura nga varri,  
statuja të çuditura  
fare.  
Sikur diç duan të thonë me gjuhën e mermertë,  
i mahniti statujat  
shekulli XX.

3.

Pranë,  
puse vajguri çohen të larta,  
punojnë të çuditshmit njerëz  
me emrin shqiptarë.  
Të tillë botë statujat s'kanë parë,  
as në ëndërrat e tyre të bardha.  
Statujat të dashuruara  
janë.  
Por statujat duar  
s'kanë,  
ndaj vetëm vështrojnë pikëlluar  
statujat pa duar.  
Pikëllim i mermertë,  
sy të trishtë,  
përpara aparate  
turistësh.

U kujtohet statujave ajo ditë e ngrysur,  
 kur lufta përdhe me ulërima i përbysit,  
 statujat me duar të prera,  
 me vinça nga harrimi të nxjerra.

Ne, njerëzit e këtij shekulli,  
 s'do lëmë që ju prapë të varroseni,  
 nga atomi s'do të groposeni,  
 s'do përbyseni varresh të ftohura,  
 statuja me duar të thyera,  
 invalide të kohërave.

IKJA E MOISI GOLEMIT

1

Kjo rruga përdridhet  
si gjarpër i zi.  
Për ku po vrapon,  
gjeneral Moisi?  
Pelerinën era  
ta ngre me tallaz.  
Gjeneral Moisi.  
Pluhur shumë lë pas.

2

Kali përpin udhët,  
muzgu bie ngadalë.  
Pse të dridhet freri  
dorës, gjeneral?

Leshrat gjithë pluhur  
të godasin sytë.  
Mbi boshllék të syve  
balli i ftohtë i yt.

3

Mbrëmja hesht mbi udhët.  
Larg zjarre çobenjsh.  
Gjeneral Moisi,  
përse shpatën xhvesh?  
Rruga është e shkretë,  
troku natën mbush.  
Veç ndërgjegjes sate  
prapa s'të ndjek kush.

4

Ik e ik përpara  
mbrëmja nxin dhe nxin.  
I ndërgjegjes troku  
prapa oshëtin.  
Kalin tënd për freri  
ajo seç ta ze,  
ti në vrap e sipër  
shpatën vrulltas ngre.

5

Moisi, ndërgjegjes,  
vallë si i re?  
Ajo erret, bie

mbytur, gjak përdhe.  
Larg dy-tri shkëndija  
patkonj shkrepëtit.  
Ndan'udhës së Madhe  
ndërgjegja jep shpirt.

6

Kali i egërsuar  
s'lë pas tym, po re.  
Qetësi pas teje.  
Ajo mbet atje.  
Mbi gropat e udhës  
si mbi plagë trokon.  
Rrafshira të zymta.  
Muzg i vjeshtës së vonë.

7

Ik, e ik, e zezë  
rruga-shkretëti.  
O, ç'e tmerrshme  
është kjo qetësi.  
Trok i tradhtisë  
natën mbyt e mbush  
kokën pas ç'e kthen,  
prapa s'të ndjek kush.

8

Rrotull një boshllëk  
shtrihet nënë re.  
Toka është vec baltë,

por jo më atdhe.  
Toka si vejeshe  
hoqi çdo stoli.  
Vdiq atdheu, mbet balta,  
nën trokun e zi.

9

Qindra vjet shkuan,  
ti lëviz si ankth.  
Dimëron në qiej,  
por dheu s'të qas.  
Në kalldrëme shekujsh  
troku yt i zi,  
Moisi Golemëve,  
gjeneral Moj-Zi.

## BALADA E ZHVARRIMIT

Dhe u sulën përsëri osmanët,  
trok i kuajve ngrij pluhur, re.  
Ulërinin rrugëve nën tufane:  
Ku është varri i xhindit «Skenderbe».

Fushat tona nën ta vajtonin,  
Qielli ynë i bukur mbante zi.  
Ndërsa kuajt përmbi dhe trokonin  
nën dhe heroi kish agoni.

Dhe e gjetën varrin te një kishë,  
shpatat e gërmuan dhenë e zi.  
Eshtrat jashtë i nxorën porsi bishat,  
midis tyre i ndanë si hajmali.

Sipas gradave i ndanë eshtrat  
gjokseve i varën dhe pastaj,  
duke tundur hajmalitë e tmerrshme  
ikën nën një dajre, nën një vaj.

... Rrugëve pa fund, betejash humbur,  
u shpërndanë eshtrat e heroit,  
drejt veriut tutje, drejt Danubit,  
ndanë brigjeve ku lufta shkoi.

Ranë jenicerët nëpër botë.  
Prapa luftërash ngelnin gjithnjë  
Varre, varre me një çallmë te koka  
dhe ca shkronja arabe, e asgjë më.

Edhe eshtrat e heroit vrapuan,  
u varrosën bashkë me ata  
rrëzave, kështjellave ku shkuan,  
në Ballkan a në Çanak-Kala.

Ku është dorë e tij e ku janë brinjët,  
që i rrihte zemra dikur.  
Mbi sa varre vallë vështrojnë yjet  
të shënuara me nga një gur?

Afër dorës ndoshta rrahin valët,  
pranë brinjës ndoshta fryn tufan.  
rrotull kafkës heshtur rrinë luanët,  
ulërijnë ujqit në Ballkan.

O, siç duket, jo, një varr i vetëm  
nuk e mbante trimin brenda dot,  
prandaj prapë u sul si erë e rreptë,  
fushave të luftës me galop.

Trupi i tij porsi një shi i tmerrshëm  
përmbi qindra sheshe luftërash ra.  
Tani toka avullon legjenda  
nga Ballkani në Çanak-kala.

... Mbi të ndritin yjet e veriut,  
ndritin yjet e jugut përmbi të.  
Larg shkretëtirash ndodhet Shqipëria  
dhe për ne një mall i rëndë e zë.

Atje larg në grykat madhështore  
maleve, luginave atje,  
rrojnë prapë njerëzit arbërorë.  
Ti në gjak të tyre varrin ke,  
o i mbeturi pa varr, o Skënderbe!

## KËNGA E MILLONAIT

Këngë e mokrave  
sonte fund nuk ka.  
Ç'heshtje pragut ti,  
o, mor millona.  
I mendimeve  
vargu nuk t'u sos.  
Cigare «Diamanti»  
ç'po tymos, tymos.

Herë zbardh mielli,  
herë mërzia nxin,  
gojëhapurin thes  
mbushin me mundim.  
Kokën grushteve,  
të të bjerë, ç'e le.  
Po përse, përse,  
millona, ti ç'ke.

Derdhet mielli,  
miell i bardhë, oh,  
martohet në fshat  
vajza që ti do.  
Do bëjnë me të  
pite, bakllava.  
Ndaj te pragu ti  
heshte, millona.

Këngë e mokrave  
sonte mbrëmjen mbush.  
Ç'të kujtohet vallë  
me kokën në grusht.  
Matanë SMT-së  
muzgu kaltërosh,  
kur puthte dhe  
«të dua» të thosh.

E trokashkave  
kënga natën vret.  
Nesër dasmë ka  
në lokalitet.  
Do të ngrejë dolli  
një shok i byrosë.  
Vetëm ti atje,  
millona, s'do shkosh.

Në mes vajzave  
s'do të hidhesh ti,  
s'do t'i vish ndër mend  
Askujt në gosti.  
Mes muzikave

s'do dëgjojë kush,  
si mulliri yt  
sonte natën mbush.

Mes trokashkave  
të duket sikur  
i gërnetës vaj  
mu në gjoks t'u ngul.  
Do të hedhë atje  
dhëndri një shaka,  
qeshje e vjehrës, ah,  
thikë: «ah, ha, ha».

vallen mblesi plak  
do ta heqë pastaj.  
Shkel opingë e tij.  
dashurinë e saj.  
Thërresin krushqit «Brom!»  
hidhen krushqit «Hop!»  
Këpucët mbi gjoks  
sikur hapin gropë.

Vetëm nuses ti,  
djalo, do t'i dhembsh.  
Do t'i mblidhet shpesh  
mu në gjoks një lëmsh.  
Dorë e bardhë e saj  
do hollojë byrek.  
Zemra jote e madhe  
shtrirë n'ato petë.

Por tek sofa ajo  
s'do dyshojë aspak,  
mos në miell ti

ke hedhur farmak.  
Ta njeh zemrën ty,  
o, mor millona,  
ndaj nga helmi yt  
ajo frikë s'ka.

C'po përtypin grurë  
nofullat me gur.  
Një miell si ky  
ti nuk blove kurrë.  
Më lehtë zemrën sot  
kishe bluar ti.  
Qepallat si plumb  
Të rëndoijnë tanë.

Herë nxin mielli,  
herë mërzia zbardh.  
Thesi ja u mbush,  
koka ty t'u var.  
Tani mielli i dasmës  
mbi supëtë ra,  
të mbuloi krejt  
porsi mjegulla...

Djalo, millona.

## *S'LINDËM NE PRINCA*

1.

Brezi im,  
jotja qoftë kjo këngë!  
Dhe unë qofsha kudo me ty.  
Dhe ne të gjithë të jemi  
drurë të mbjellë në udhëkryqet e historisë,  
tabela të kuqe përpara kohërave të vështira,  
me mbishkrimet:

«Kohëra të shpëtuara».

Ne ta spastrojmë këtë planet  
nga prangat, superfuqitë, poshtërimi,  
që ju pas nesh, kur të vini,  
ato mos t'ju pëlcasin ndënë këmbë  
si mina.

Me këtë këngë s'kujtoj se po bëj  
tablo apo përgjithësime epike gjithfarë,  
me këtë këngë dua vetëm t'i ngjaj

shkollarit, që në sallën e postës  
një plakë i lutet ngadalë  
t'i shkruajë mbi zarf një adresë,  
ndoshta adresa e të birit ushtar.

2.

Ne erdhëm në jetë  
në kohëra plot duman.  
Ne erdhëm si ajo nusja e veshur me të bardha  
Që pjek në rrugë një funeral vigan

Ne erdhëm si manushaqe të hershme  
mbi varrin e ushtarit.  
S'lindëm ne princa,  
megjithatë  
mijëra topa përshëndetën ardhjen tonë,  
ish kohë e hekurt, kur në qiej  
më shumë bombardonjës  
sesa zogj fluturonin.

Dhe qysh atëherë dhe gjera tani  
unë zogjve akoma s'ua di emrat mirë,  
ne markat e aeroplanëve  
atëherë si abecënë dinim!  
Nga zhurm'e motorëve i njihnim,  
siç duhet të njihnim  
zogjtë nga cicërima.

Mëso netve më vonë zoologjinë,  
merr diplomën në veterinari...  
Zogjtë po nuk erdhën me fëmininë  
nuk vijnë më kurrsesi.

Kështu, pra, u rritëm  
n'atë kohë të rreptë,  
ne të pazogjtë,  
aeroplanmëdhenjtë!

3.

Mirëmengjes, Republikë!  
Ndiej frymëmarjen tënde ritmike.  
Tek përkulesh  
me syza të zeza  
mbi fisat oksidrike.  
Mirëdita, Republikë!  
Këto tela tensioni të lartë që zgjaten pa kufi,  
Që si nuse me tela të stolisin,  
janë nervat e tua të nderura,  
nervat e tua të hekurta,  
Shqipëri.

Mirëmbrëma, Republikë!  
Shoh moshatarët  
ngjitur mbi shtylla  
mbërthejnë llampa  
mijëra dhe mijëra,  
sikur montojnë  
një qiell me yje.

4.

Ka në jug një lumë  
që ka tre mijë vjet  
që buron nga malet,  
që rrjedh nëpër Eneidë,

që rrjedh bile n'Iliadë  
e mes mitesh të motshme.  
Akeroni i skëterrës,  
Bistricë e sotshme.

Mbi këtë lumë vozitën  
turma të vdekurish  
me qefinë të bardhë.  
Me koka të verdha,  
të qullura nga shiu,  
të ngrira nga era.

Ky lumë, që shekuj mbi valë  
shtyu varkën e Karontit,  
turbinat do të shtyjë  
dhe mbi të do lëvrijnë,  
jo më mijëra shpirtra,  
jo miliona elektrone.  
Dhe ti, xha Karont,  
erdh koha —  
në pension.

Braktise varkën e vjetër,  
vozite trë mijë vjet,  
Se erdh një kohë e madhe,  
Xha Karont,  
Varkar i lashtë sa bota,  
xha Karont,  
(Dhe ovullat që u more të vdekurve!  
kur i goje në botën e amëshimit,  
depozitoji, xha Karont,  
në Sarandë,  
në arkën e kursimit!)

Po, o brezi im,  
ne kemi punë sot  
me Akeronë  
dhe Karontë,  
Kjo s'është kaq e thjeshtë  
sa të shkulësh një fletë  
nga e lashta Eneidë.

5.

Eja, ulu këtu,  
xha Karont,  
o filozof i vdekjes,  
ulu të kthejmë një gotë:  
Për të gjithë brezat nuk ka pasur  
kryqëzor më të tmerrshëm  
se varka jote.

Ulu dhe më trego  
për miliardet e shpirtrave,  
që transportove në atë botë,  
për skllevërit, gratë e bukura, zyrtarët,  
heronjtë, kuzhinierët, carët:  
Tregomë,  
si me kujën  
e erërave përzihej  
kuja e tyre  
mes rrëmujës  
së ujërave,  
që rrrokulliseshin  
rrokopujë.

I frikshëm tregimi yt, Karont,  
i frikshëm dhe i madh;  
me këto shpatulla,  
duke lëvizur lopatat,  
ke tërhequr  
një botë të tërë të vjetër  
drejt vdekjes.  
Po tani më dëgjo mua, xha Karont,  
të të tregoj diçka  
nga bota jonë e të gjallëve.  
Të tregoj për brezin tim,  
që varkën tënde  
do ta copëtojë rrëzë maleve;  
të tregoj për brezin tonë,  
që, mbi tryezë, ku pleqtë lozin dominonë,  
në vend të 4-3-shit  
harushën e madhe mund të zbresë!  
Se ka një forcë të madhe  
sot Shqipëria,  
q'u shtohet maleve, stuhive, krenarive  
të saj.  
Forca e re:  
Partia!

## 6.

Popujt  
janë si anije të mëdha.  
Në det të historisë qëllonte që shtrëngatat  
u thyenin direkët,  
i zhytnin në errësirat si nata.  
Partia

ishte periskopi,  
që nga errësirat  
përgjonte horizontet  
dhe vendoste:

Këtu

dë të dalim mbi ujëra prapë!

Si gjeni i detit,

prej ngjyrës së stërkalave

Partia dallon e para

erërat si fryjnë.

Forcën, drejtimin dhe njëlmësinë e valëve,  
nga grumbullimi sipër saj i reve

dallon stuhinë,

Si shkëmbinj të nënüşhëm nën vete  
zbulon trädhtinë.

7.

Këtë tokë të sigurt, që quhet atdhe,  
na e lanë brezat që ikën,  
që ne të tjerëve t'ua lëmë  
kaq sa e gjetëm,

më pak asnjë pëllëmbë!

Atdheu im shtatlartë,

plot muskuj, pa bark e dhjamë,  
fytyrëhequri, burrërori,

shamikuqi,

i` pathyeshmi,

madhështori.

Kur mbreti Genc, i kërrusur,  
karrocën tërhiqtë nën Harkun e Triumfit  
të Romës krenare,

u nxinë nga turpi këto male,  
u nxinë, po s'u dhanë,  
u mbështollën me mjegulla,  
nga uria  
Rrufetë hanin,  
dhe prisnin që trupi të lahej,  
Këto male të shkreta.

O Hark i Triumfit të Romës,  
nën këmbët e tua të gjymtuara  
tani enden turistët e huaj.  
Si mund të kalonte atdheu im shtatlarës  
nën kubenë tënde,  
më thuaj?!

Harqe triumfi,  
ëndërrime të përkulura  
mbi koka të ulura.  
harqe triumfi,  
projekte zgjedhash  
mbi zverqe të skuqura  
Nga plagë të tmerrshme.

Harqe triumfi,  
sy të shqyer tiranësh  
mbi trupa të mundura!  
u shembët ju,  
por mbetën në botës  
popujt  
dhe malet e patundura!

Dëgjoj në qetësi të natës mbretin Genc  
fatkeq.

Se si drejt errësirës dhe harrimit  
atë karrocë turpi përjetë tërheq.  
I munduri, i vetmuari mbreti Genç!

Ne  
rrugë të tjera çajmë,  
të pathyer,  
me një lëvizje bërrylash  
çdo hark triumfi të huaj përlajmë,  
nderin e atdheut  
Më lart të këto male e mbajmë!

### 8.

Ti, brezi im,  
brezi i mezit  
i shekullit XX,  
vezme me plumba  
e shekullit XX.  
Lufta mbi kurmin tënd  
s'do të kalojë,  
rrezet radioaktive  
ëndrrat nuk do t'i përvëlojnë.  
Telat e llogoreve

Kapotën s'do ta shpojnë,  
armiku këndeje s'kalon.  
Një pengesë të madhe do ngrejmë  
me armë, bajoneta, këngë,  
tela hekuri, nerva, ëndrra  
pleksur:  
në të madhë, të tmerrshme  
pengesë.

Prapa armik! Na njeh?  
Jemi ne,  
Ne  
rrip i mezit,  
rrip vezmesh  
i shekullit luftëtar.

Minat në s'mjaftofshin,  
shpirtrat tanë si mina do vendosim  
fushave të pambaruara,  
që ti të mos kalosh.  
O fusha, të tmerrshme,  
me shpirtra të minuara!

Dhe nga metali i shkrirë  
në fushat e betejave,  
nga metalet e predhave,  
të llogoreve, telave  
shqyer mbi hone,  
gjeneratat  
le të ngrejnë  
monumentin tonë!

O brezi im,  
Kjo mos ndodhtë!  
Për pëlcitje atomi  
mos u bashkoftë!  
Po edhe në ndodhtë kjo,  
ne prapë fitimtarë

nga fushat e betejave do të kthehem  
plot flamurë të kuq.

Dhe fasha të bardha.

Dhe fashat në s'mjaftofshin,  
me re do ti lidhim

plagët e hidhura,

me mjegulla të bardha

do mbështillemi,

Në kaltërsinë e mëngjeseve tëardhme  
do të kridhemi,

në gjokset njerëzore drejt nga gjiri

do të hidhemi.

i vdekjes

## 10.

Të shoh, brezi im,  
sot ngjitur mbi shtylla,  
monton ti llampa  
Mijëra dhe mijëra.

Nesër

në qiej ti do të sulesh të pasosur  
të shtrosh të ftohtat trase të universit  
dhe i pari ndër orbita të vendosësh shenjatë  
«Përpara»,  
«Zigzag»,  
«Kthesë».

Po, o brezi im,  
sot nxjerr ti në pension  
të lashtin varkar Karont.

Nesër në udhëkryqe, mes yjeve, m  
trafikun do t'u mësosh perëndive.

Do të digjen semaforët e tu  
Në kozmos natë e ditët  
I mëdhaje ti, brezi im, e tpi da bëz  
nesër  
Do të gjobosh perënditë.

## 11.

Në këtë shekull shpejtësish,  
më shpejt se Tu-104,  
më shpejt se sputnikët në fluturim  
fluturojnë vitet e tu,  
brezi im.

Fluturojnë vitet e rinisë,  
ditët shkunden një nga një,  
si pendët e shqiponjave.

Ditët bien si rëra prej balonave,  
që më lart balonat të ngjiten  
në gji të pafundësisë.

Kështu ikshim një nga një, duke u ngjitur,  
duke shpërthyer tavanet plot tym duhani  
të klubeve,

ku pijnë aranxhata,  
dhe mezi shqiptojnë «Lumumba».

Ne do ikim  
jo të kërrusur mbi bastune,  
po në sfonde shtyllash tensioni të lartë  
do të erremi si silueta  
horizonteve të lume.

Ne do t'ikim nga kjo botë si një funeral i  
vogël që pjek në udhë një dasmë të pamatë,  
Ne do t'ikim siç hiqen afishet e qullura  
Pas një shfaqjeje gjigande, pas mesnate.

## KITARISTI

Kokën si shpellë e ka mbështetur mbi kitarë,  
gjashtë telat si gjashtë udhë zgjaten në  
mugëtirë.

C'pe ashtu mbi tela,  
që me dorën e madhe  
i re rëndë-rëndë  
dhe e dëbove prej tyre?

Kë thirre vallë tjeter;  
që menjëherë, ja,  
ku përgjigj thirrjes sate dhe mbi telat erdhi,  
duke shkelur lehtë e ëmbël,  
gjersa shkau e ra  
në gropën e kitarës  
si në një hon të thelli?

Pastaj dora jote mbi telat mbolli lule,  
pastaj prej tyre shkundi

fletë të verdha.  
Pastaj, për një çast,  
të shkretë telat mbetën,  
si udha dimërore, ku fryn veç era.

Kitarist,  
mos i lër telat të ngrijnë,  
shkunde dëborën prej tyre, shkunde,  
të mos bëhen telat rrugica të mbyllura,  
të jenë telat udhë të pafundme!  
Dhe prapë mbi gjashtë telat ai dëbon e thërret  
herë trishtimin e madh,  
herë harenë e madhe.  
Mbi këto gjashtë udhë që e lidhin me jetën  
ngrihet kokë e tij si një shpellë krenare.

## LOKOMOTIVA

1.

Në bregun e shkëlqyer të detit,  
në sfond të bardhë valësh, resh e irrezesh,  
pranë pistave të dancit,  
ndanë hotelesh e kaltërsish,  
lëviz ti ngadalë,  
njollë e zezë,  
duke rënkuar mbi binarët,  
e rëndë, e ngrysur lëviz.

Lokomotivë e plazhit, lokomotivë e vjetër.  
I çon mysafirët detit,  
i heq mysafirë detit.  
Prodhuar më 1940 në Essen të Gjermanisë,  
ndanë një deti të huaj po i ngrys  
ditët e pleqërisë.

## 2.

Je lodhur, e plakur,  
ofshan, djersin e nxjerr shkumë.  
Pas çdo udhe që bën  
lodhesh edhe më shumë,  
megjithëse tärheq një peshë kaq të lehtë  
siç është lumturia...  
lokomotiva e zezë, lokomotivë e vjetër.

## 3.

Pranë një deti të huaj  
ç'gëzim vallë të ka mbetur,  
veç këto çifte të rinjsh,  
këto vajza të shkujdesura,  
këta fëmijë që imitojnë zhurmën tënde të vjetër.  
Duke të ndjekur pas me britma e të qeshura,  
E megjithatë, ti këtu je e huaj,  
një plaçkë lufte,  
një njollë lufte e zezë  
në këtë sfond të kaltër uji e rrëzesh.

## 4.

Si invalidi plak, që në luftëra u sakatos  
dhe i gjallë pas luftërave diku mezi u sos.  
Dhe i japid pastaj një punë të lehtë,  
ashtu dhe ti, lokomotivë e detit,  
nga plazhi në qytet shërbën tanë,  
për herë të parë tärheq kaq lumturi,

për herë të parë tê rheraq gjëra të kthjellta,  
kaq gjëra të bardha  
mbi trupin e madh, të zi,  
lokomotivë e luftës, lokomotivë e ashpër.

5.

Pranë detit të qetë, pranë dallgëve,  
të kujtohet rinia kaluar mes flakëve.

Nga njëri skaj i Evropës në tjetrin skaj  
nga njëri front në tjetrin front,  
duke vrapiuar me vërvëllima, sirena e vaj,  
nga njëri horizont i ngrysur në tjetrin horizont,  
ti suleshe përpara ditë e natë tutje,  
duke klithur si shpend i egër,  
duke i rënë borisë së luftës,  
përmes peizazheve, gërmadhave, reflekseve të  
zjarreve,

mes qytetesh, që bijtë ua merrje,

mes miliona duarve, qarjeve,

shtyheshe përpara,

ulërije

sipër shkretëtirës së ndarjeve,

pas vetes

jehonat u lije hapësirave,

trishtimin binarëve.

6.

Nën re, nën shi, nën alarme, nën avione  
tërhiqje e tmerrshme  
divizione, divizione.

Herë herë,  
nën shiun e mërzitur,  
përmes gërmadhave,  
ktheheshe bosh nga frontet  
vetëm me shpirrat e ushtarëve.  
Me vagonat rresht të lagura nga mjegulla  
dhe sipër një hënë ulëritëse.  
Ishin shpirrat e ushtarëve më të rënda se  
ndaj ti gulçoje e ngrysur. tanket,

Ktheheshe trishtueshëm  
dhe ulërima jote ishte më therëse.  
dhe ngjaje e gjitha si një kllapi e zezë,  
hamall i tmerrshëm i luftës,  
lokomotivë e vdekjes.

-7.

Mos èndërron prapë të sulesh si veri  
rrugëve të luftës  
e hekurta shtazë,  
tani që mbart e bie kaltërsi,  
si invalidi plak,  
që si mbarti murtaja në front  
tani mbart e bie ujë në dasmi?

Ti, që mbi supe mbajte vdekje, regjimente,  
ushtarë,  
ndoshta të vjen turp që mban tani në krahë  
buzëqeshje vajzash të nxira nga dallgët,

dhe vetja të duket ndoshta si një dado,  
që ngre kaliboç nipër të huaj,  
lokomotivë e zymtë, lokomotivë e ashpër.

8.

Ndaj, kur vjen muzgu herë-herë,  
kur ti dremit atje në bregun me shkumë,  
në mes qetësisë së madhërishme  
lëshon ndonjë klithmë,  
sikur trembesh në gjumë.

Dhe me klithmë ndonjë nga shoqet të përgjigjet,  
dhe heshtni prapë  
në paqën e mbrëmjes sipër shinash,  
silueta të mëdha,  
në këtë orë të vonë,  
ju kap një mërzi e zezë lokomotivash.

Së shpejti do fillojnë anë detit shirat,  
do mbyllen plazhet,  
do t'ikin kaltërsitë,  
gjethet e verdha do fluturojnë sipër shinave,  
do të bien ngadalë mbi shpinën e çeliktë,  
ti do të rrish pa punë  
e vetme në breg të detit,  
ujërat do të shkëlqejnë mbi pjesët e rënda  
dhe ti do të qash me lotë të fuqishëm  
pleqërinë e zezë tënde.

## **SHOQES QË U MARTUA**

S'të erdhi shkesi me qeleshe,  
Veshur pas modës ai t'erdh,  
Po rrjedh ai nga lloji i shkesëve,  
Si macja që nga tigri rrjedh.

Dhe nuk të shitën ty me pare,  
Sipas kanunit t'egër, por  
i zëvendësoi makina larëse  
Dhe i magjishmi televizor.

Qëndisma s'thur, s'ngarkon bucela;  
Vjehrра në mbrëmje s'të bërtet...  
Ti hap e myll bufenë moderne,  
Shkon në kafe, shkon në koncert.

Por mund të veshësh minifunde,  
Mund të lexosh anglisht nga pak,  
Megjithatë në fund të fundit  
Ti mbete nuse me duvak.

Kanuni ndërron si ujku qimet,  
Por nuk ndryshon esencë e tij.  
Ai pranon shumë kompromise,  
Një gjë s'pranon, veç dashurinë.

S'të erdhi shkesi me qeleshe,  
Me pardesy sezoni erdh,  
Po rrjedh ai nga lloji i shkesëve,  
Si macja që nga tigri rrjedh.

## *FILLROJTËSI*

Pjetër Llesh Dodës

Sa herë që ngrë receptorin e telefonit,  
më duket se dorën tënde, Pjetër, kap.  
Alo. Është vonë, e di.

Ti ke rënë diku në dëborë, tej një gryke.  
Bëj një mundim të fundit, ngreje receptorin  
si ushtari i vjetër armën besnike.  
Alo.

Por ty dora të ka ngrirë,  
ti s'lëviz më.

Ti që gjithmonë përgjigjeshe «Jam këtu»,  
tani s'je më asgjékund,  
dhe je kudo.

Kudo, pérherë në ecje,  
nën telat e gjatë që ikin drejt peizazheve të  
shqetësuara,

nën biseda të ngrohta njerëzore, si nën çatinë  
më të bukur.

Na ikën e na ikën gjithmonë, të themi «kthehu»  
e s'kthehes,

diku është këputur një fill, një bisedë mbeti  
përgjysmë,

ti ngrihesh i bardhë, nga gjiri i dëborës,  
dhe shkon ta lidhësh atë që u këput diku.

Ti poshtë, telat lart.

Tela të mbushura me fjalë,  
me dashuri, me pritje, me lajme nga tereni.  
diku filli është këputur, diku fjalët kanë

ngecur  
si një turmë e zhurmshme në një stacion treni,  
«Ç'bëhet? Kur do të nisemi? Pse ngecëm?»  
Presin që të vish ti, t'i çosh më tutje  
Dhe ti po shkon. Fryma të merret. Ecën.

Komititetet e partisë pyesin për të mbjellat,  
dikush lajmëron për fejesat e mitura,  
për plehun kimik, për hoxhën që e dëbuani,  
për autokinemanë që akoma s'ka mbërritur.  
Gjithfarë fjalësh e zérash vrapojnë nëpër mal.  
Midis zérave dhe furtunës ndihet zëri i meskinit:  
«A doli stof terital? Alo, stof terital».

Ti ikën.

Meskinët në kabina dhe dhoma të ngrohta  
larg grinden, bëhen nevrikë,

«S'dëgjohet mirë, ç'është kjo punë kështu?»  
Centralistet me zërat e mërzitur përmes

çamçakizit  
murmuritin me hundë «Alo, alo, alo».

Ti ikën.

Ndoshta një nënë do të flasë me djalin ushtar.  
Rri nëna mbi stolin prej druri në sallën e postës.  
Salla u boshatis. Është vonë. Po ajo pret.

Ti ecën dhe gjithë peizazhi të duket si një  
fletëthirrje telefonike e bardhë

në duart e nënës së ushtarit.

Dëbora vërtitet me ulërimë në mal.

Pesë kilometra, gjashtë, ç'mundim të çash mes  
saj,

ndërsa dikush diku trishtohet.

Për një metër e njëzet stof terital.

Ti ecën.

Kthehu, të thonë këmbët, duart, gjymtyrët,  
kthehu, na lodhe shumë.

Mbrëmja dhe mali thonë, kthehu.

Qepallat të mbyllen. Të vjen gjumë.

«Natën e mirë, natën e mirë, natën e mirë».

Centralistet u ndërruan. Ç'është kjo «natën e  
mirë» kështu?

Se si tingëllon ndryshe,  
e çuditshme.

Ti mbajte këmbët.

«Natën e mirë», na the të gjithëve.

Re në dëborë.

Natën e mirë, pra.

Re në kujtesën tonë, në këngën që e kishim  
gati si një vig.

Koka e thinjur të lëkundet anash.

Alo.

Tani koha u ngroh.

Mbi varrin tënd ka mbirë bari.

Mbi varrin tënd të mblidhen shokët,  
të ngrenë një shtyllë telefoni të madhe,  
një shtyllë me shumë tela dhe izolatorë të bardhë,  
ku era të vërvshëllejë «Alo, alo».

## KALI I TROJËS

Në qetësinë e natës vini veshin,  
a nuk dëgjoni që larg një trok të mbytur?  
Nga thellësitë e miteve të lashta drejt qytetëve  
tona moderne  
po trokon e avitet një kalë.  
Eshtë Kali i Trojës.

Në hapësirat e shkreta, të përmbytura nga drita  
e bardhë e hënës,  
ndiej patkonjtë e tij si shkelin mbi pellgjet e  
zëmtrë,  
mbi shpinat e shekujve shkelin potkonjtë viganë.

Afrohet.

Me zgavrat e drunjta vështron që larg kohën  
tonë,  
shtëpitë, kullat e radiostacioneve, antenat.  
Dhe prapë ecën.

Ecën drejt nesh.

Pér se i le gërmadhat e Ilionit, ç'kérkon,  
që midis kohérave endesh si sonambul?  
S'të mjaftuan zjarret, tempujt, klithmat e Trojës,  
S'të mjaftuan qytetet, që hëngre në kohët e  
mëvonshme?  
(Tani hënë e bardhë, e vdekur mbi to shndrit).

Sa hierë ke hingëlluar me atë hingëllimën tênde  
të llahtarshme,  
kur i shihje si po jepnin shpirt  
Nën këmbët e tua?  
Dikur dhe ato ishin qytete si gjithë qytetet.  
Jetonin. Oxhaqet nxirrnin tym. Vajzat buzë-  
qeshnin,  
por si mallëkim në horizont u shfaqe ti.  
Ata tê hapën portat, s'dinin ç'ishe.  
Pastaj (o, pastaj) kur flakët përdridheshin,  
gjindja ulërinte,  
Klithnin «oh, tradhti!», por ishe vonë.  
Qytetet dergjeshin përdhe tërë plagë, tymra e  
zjarre.  
Te jepnin shpirt, ndienin mbi gjoks një peshë,  
ca si potkonj tê tmerrshëm.  
Hapnin sytë me zor.  
Mbi gjoks tê tyre ti kishe vënë këmbët si një  
ankth  
dhe po u merrje frymën.

Qyteti vdiste  
mbi rrugët, sheshet, trotuaret  
mbinte bari si qimet mbi një fytyrë tê vdekuri.

Ti ikje më tutje,  
kërkoje një tjetër.  
Përbindësh, me mish qytetesh u mësove.

Ikën. Trak-truk. Fushë e bardhë. Hënë.  
Zgavrat prej druri i rrötullon ngado  
ja, më tutje në horizont  
sinjale, kupole, duken,  
udhëkryqe, drita...  
Andej drejtohesh.

Kështu gjithmonë endesh, duke kullotur vdekjen.  
As lufta, as uria, as murtaja,  
nuk kanë ngrënë kaq qytete sa ti,  
(Kaç bulevarde, salla postash, teatro, apartamente,  
kryqëzime rrugësh, vajza që shpejtojnë në  
fabrikë, djem me cigare)  
tani kërkon përsëri.

Prapë ke uri.  
Barku yt i drunjtë s'ngopet kurrë.  
Zgavrat e tua të errëta i ke drejtuar mbi ne.  
Ngadalë po avitesh. Ndihen potkonj.

Trak-truk me ritëm hekzametrik  
potkonjtë e tu po ndihen.

Vini veshin!

Në gjumë, përbindësh, dot s'ke për të na gjetur.  
Vini veshin! Vini veshin!

Kali i Trojës!

## TOPAT E VJETER TË DURRËSIT

Me tytat e gjata, të nderura sipër detit,  
ndryshken në diell e në shi topat mbretërorë.

Ata heshtën atë ditë që duhej të gjëmonin.  
Turpi dhe harrimi mbi ta pushon.

Kalimtari i rrallë, q'andej i bie rruga  
derdh ujët mbi ta, në orën e muzgut.

## ATJE LARG, NË VERI

## MOTIVE ME DIELL

Mbi liqenjtë e Lurës po bie mbrëmja.  
Muzgu rrjedh nga majat e pishave nëpër  
trungjet e kalbura,  
Grumbullohet në pellgje të vogla.  
Kullon pastaj nëpër furçën tënde të dridhshme.

Shpejto.  
U bë vonë.

Kap q'të kapësh nga ngjyrat që dridhen e  
fërgëllojnë,  
duke ikur plot alarm nga mbrëmja që i ndjek.

Kap motive me diell...  
Nëpër furçën tënde kurrë nata mos kulloftë.

## FUND VJESHTE

Autobusët urbanë nga periferitë  
drejt qendrës mbi xame sjellin brymën.  
Vjeshta si luaneshë krifëverdhë  
ruan ditët e fundit nga dimri.

Te vitrinat, te xhamet e kafeve,  
kalimtarë të shumtë ka,  
në reflekset e flokëve të tua  
një nuancë e kuqërremtë ra.

Pranë ditëve të tua të bardha  
kalova sot rastësisht.

Ti u trembe? Unë ujk nuk jam,  
(as dele nuk jam natyrisht).

Po ti eja, atje të shkojmë,  
(pa përfillur fjalët e botës),  
Ku nga avulli xhamat e kafeve  
ngjajnë si pamje që s'janë në fokus.

N'autobusët urbanë eja,  
të shkojmë periferive me brymë.  
Të shkojmë si vjeshta krifëverdhë  
ruan ditët e fundit nga dimri.

Sdot e sot funda pas orës së 17  
mbrojtërenët është edhe i derdha vjetoritët. M  
i qëqë

## EPITAF PËR AVIATORIN NIKO HOXHA

Ti e deshe kaq shumë këtë tokë.  
Në stërvitje shpesh i aviteshe me të tmerrshmen  
shpejtësi.  
Një ditë  
kaq shumë  
në pikatë  
iu afrove,  
sa ajo zgjati dorën dhe të mori në gjë.

## **MOTIVE PËR ELEKTRIFIKIMIN E PËRGJITHSHËM TË SHQIPERISË**

1.

«Pak dritë, pak dritë...»  
Ç'është ky zë i thellë,  
kush e ka humbur rrugën buzë humnerave?  
Është Migjeni,  
kérkon një pishë; vërtitet,  
hapat e tij gjëmojnë thellë gropave të poemave.

Pak dritë,  
po dritë s'ka,  
nata rëndon  
mbi udhët, tjegullat e pullazit, mbi fatet,  
mbi mërzinë e vajzërisë, plazhet, klithmën e  
gjaksit, mbi këngën e bulkthit, vetminë e shkrimtarit.

2.

Gjeografia ekonomike.

Shqipëria, tabelë.

Kaç grurë, kaç dele, kaç krom, hekur-nikel.

Sa ishte energjia elektrike për frymë?

Ah, mbylle librin dhe hap më mirë dhembjen.

Ashtu siç hanim një herë mish në vit  
në dasmë apo në zi.

Ashtu e merrnim  
gjithë dozën e elektricitetit të vitit befas  
në formën e një rrufeje vdekjeje.

Ky gjëmim i shkurtër,  
kjo dritë e bardhë  
i vetmi elektricitet mbi kaptinën shqiptare.

3.

Ujërat hidhen në male si dhitë e egra,  
ne do t'i ndjekim pas,  
do t'i zemë përmes shkrepave,  
ujërat bien rob në qafat e maleve,  
dhe sajohen mjekrat e hidrocentraleve.

Në pjerrësitë e digave shkumë e bardhë,  
stërkala, ylbere, lëvizin, rrëshqasin.  
Përmes dritës komuniste, mbi betonin e digës  
derdhet mjekra vigane e përjetshme e Marksit.

4.

Dhe do të shfaqen kudo majë shtyllave — të  
larta,  
Grumbuj-grumbuj si zogj,  
izolatorët e bardhë,  
zogj, që nga stina e komunizmit na kanë ardhur.

5.

Do të bëhet drithë,  
s'është bibla që flet.  
Është Partia, zëri i saj si gjëmimi  
kalon përmes zemrave të popullit si përmes  
reproduktoreve,

Rritet e rritet gjithnjë:  
(C'jehonë madhështore!)

6.

(Dhe kur të shkojë malësori i vogël në teatër,  
kur të shohë pjesët e zymta të Shekspirit,  
do të thotë me vete:  
Natyrisht kaq intrigë  
të frikshme e të errëta ka pasur në mesjetë,  
gjersa s'kishte hidrocentrale  
dhe elektricitet!)

## VALLJA SHQIPTARE

Tri herë opinga rrahu dheun,  
sikur kërkoj leje prej tij.  
Pastaj shamia palët ndehu  
me qetësi dhe madhështi.

Kështu midis qiellit edhe tokës  
vallja u lind, vallja u shpall.  
Këmba sinjale i çon tokës  
dhe dora qiellit i jep lajm.

Dhe vallja rrokuilliset tutje  
në kohëra hedhur si hobë,  
prilli përsipër i hedh lule,  
Dhjetori borën shkund atje.

Valle shqiptare, shenja n'erë.  
Ylbere tirqesh tej-tëhu,  
Kush ju kërceu ju njëherë  
dhe këmbët rob s'i mbenë te ju.

Kush ra midis vorbullës suaj  
dhe s'u përzhit, dhe s'u përflik.  
Ju bubullima me opinga,  
që nëpër shekuj bridhni varg.

## KOHA E POPUJVE

Kur superkafshët dridhnin botën,  
njeriu në gjunjë nuk u ul.

Ka pasur vite të mamuthëve,  
po kohë të tyre s'pati kurrë.

Me brirë të tmerrshëm e klithma kobi  
mbi tokë ata vunë ligjin bishë;  
megjithatë ish kohë e njerëzve  
dhe ky planet i njerëzve ish.

Nga superpesha u vinte vdekja,  
ngecnin përbindshat në batak.  
Kështu do ngecin supershtetet  
në llum të globit pak nga pak.

Dhe kur në të ardhmen do zbulojnë  
eshtrat e tyre nëpër botë,  
ashtu si eshtrat mamuthore,  
që zoologët gjejnë sot.

Kur tē zbulojnē konstruktet, dhëmbët,  
atē burokratizëm-hata,  
ç'heronj, do thonë, kanë qenë  
popujt që rrojtën tok më ta.

Ata q'u ngritën përballë tyre,  
që u qëndruan trimërisht,  
ish kohë e tyre ajo, do thonë,  
dhe ky planet i tyre ish.

## LULEMOLLET

Lulemollët nën dritën e Hënës  
Bien si brilantë diku.  
Ekin qiellit patat e egra  
Me pak hënë në krahë gjithashtu.

Për të qenë një mbrëmje e bukur,  
Pak gjëra i mjaftojnë, fare pak.  
I mjafton një shtresëz hëne,  
Si bukës së mëngjesit pak gjalpë.

Për të qenë e bukur kjo udhë,  
Ritmi i hapave tonë i mjafton.  
Ja patat e egra nga krahët  
Shkundin hënën pikë-pikë si limon.

Nga dritaret e shtëpive fshatare  
Copra lajmesh të TV-së vijnë nga larg.  
Për lulet e mollëve po të fliste  
Spikerja,  
s'do të çuditesha aspak.

N'Evropë jemi vëndi i vetëm,  
Që në mbrëmje më parë se gjithshka  
Japim lajmet për njerëzit e thjeshtë  
Të uzinave dhe fushave të mëdha.

Mbledhin buzët me siguri ish-zotërinjtë:  
Uh, q'lajme pa lezet, «me fshat»,  
Ata që më të rëndësishëm se drithërat  
Quajnë çdo krim e psikopat.

Pështyj mbi sensacionet e përtej detit,  
Mbi «yjtë» e «superyjtë» e gjithë ç'janë,  
Të gjithë ata bashkë dinjitetin  
E një are me grurë s'e kanë.

Gjithë reklamat e tyre së bashku  
S'kanë kaq dritë sa këto lulemollë,  
Lulemollët që ndershmërisht bien.  
Pa kërkuar asgjë,  
nën hapat tanë.

## **ALPET NË DHJETOR**

C'është ky vend kështu, këto pllaja me brymë,  
me malet sup më sup e kokë më kokë përpjekur?  
Ja qelli gri i lartë, mes tij një bubullimë;  
si e plagosur ikën, një shpellë të gjejë për të  
vdekur.

Hotelet janë larg dhe ne vazhdojmë të ikim,  
nën borën që floknajën e saj rrëzon përqark.  
Thua se kodrat nisen për në dasmën e Halilit,  
thua se brigjet kthejnë nga vdekja e Mujit larg.

Gjithçka është madhështore nën këtë borë  
bashkuese,  
në përzierjen e maleve dhe të njerëzve epikë,  
nën këtë quell të madh nga shkrepëtima  
pëershkuar  
si nga qerre gjëmonjëse tragjedish antike.

Me udhëkryqe, ndan xhadëve  
ditët e shtuna dalin shpesh,  
dhe zgjatin dorën nga makinat,  
herë dy nga dy, herë vec e vec.

### MËSUESET E ESHATIT

Me udhëkryqe, ndan xhadëve  
ditët e shtuna dalin shpesh,  
dhe zgjatin dorën nga makinat,  
herë dy nga dy, herë vec e vec.

Por shpesh ata që janë brenda  
me njëri-tjetrin shkëmbejnë fraza:  
«Si shumë pretendime kanë,  
mor, shoku Jani, këto vajza».

Dhe janë ata që bëjnë zhurmë,  
që kanë për vete dyzet gojë,  
që i shkruajnë letër Presidiumit  
për një kuzhinë, po t'ju mungojë.

Dhe ato presin makinë tjetër,  
atje në rrugë, atje në shi.  
Ato, të urtat gjer në dhembje,  
të thjeshtat gjer në madhështi.

Te presin, java që kaloi  
u rikujtohet si në tym,  
klasa me nxënësit, gabimet  
q'u përsëriten në hartim.

Në mbrëmje radion dëgjon njëra,  
tjetrës ndër mend i vjen sérish  
shikimi i fotoreporterit,  
q'andej kaloi rastësisht.

Kohë e fejesës i ka ardhur,  
dikujt dhe ndoshta i shkon çdo ditë...  
Pluhur i shkumësit, vello e bardhë  
i bie mbi supe dhe e trondit.

Po s'ngrënë ato botën në këmbë,  
në komitet, në ministri.  
**Ato** të urtat gjer në dhembje,  
të thjeshtat gjer në madhështi.

## **PORTRETI I SKËNDERBEUT**

Si ditë e plotë ai shtjellej  
me rë dhe erë mbi atdhe.  
Një emër, Gjergj, e kish si diellin,  
tjetrin si hënën, Skënderbe.

Dy brirë dhije kish mbi krye,  
emblemë e vjetër e çuditshme,  
sikur ta dinte që mes brinjëve  
dy perandorë do të godiste.

Njëzet e katër luftëra bëri,  
njëzet e katër vdekje theu.  
Çka mangut linte ditën Gjergji,  
plotësonte natën Skënderbeu.

Pas vdekjes eshtrat iu ndanë,  
në mijëra varre ato u shtrinë.  
Gjithçka të shumtë ai e pati,  
të vetmen kish veç Shqipërinë.

## NISJA E SHQIPTAREVE PËR LUFTE

U nisën për luftë, «bënë tutje»,  
pa fjalë të mëdhë e pa këngë,  
me opingat me xhufka të kuhe  
si me zjarre të vegjël mbi këmbë.

Ikën larg që të gjehin armikun.  
Çdo armik, në çdo breg, që ta gjesh.  
Kaq të thjeshtë luftën e kishin,  
sa që «tutje» e quanin thjesht.

Në çdo anë që të ecnin, patjetër  
do t'u dilte diku midis shqotës,  
ajo ishte për ta pjesë e jetës,  
ish përmasa e katërt e botës.

Dhe kur bini në prillena në vjeshtra  
nëpër brinja të shtrirë, nëpër lugje,  
si me zjarre të vegjël të përjetshëm  
era loste me xhufkët e kuqe.

## PORTRËT MALESORI TË HERSHËM

Mbi tirqet vijë e zezë  
zbret si e zezë vetëtimë,  
në brez armën e mbushur  
në kokë të zbrazëtin qefin.

Këshitu është shfaqur në vite  
rrafshnaltave gjer në det.  
Në brez vdekjen e tjetrit,  
në ballë vdekjen e vet.

Kur ndonjë ditë armiku  
shfaqej diku në kufi,  
kundër tij më të dyja vdekjet  
nisej ahere ai.

## **NUSET DHE DASMAT**

Të veshur me mjegull  
me copëra yjsh,  
nuset e krahinave  
të Shqipërisë.

Aq të bukura dasmat  
n'atë dekor të zi,  
sa që dhëndër do ndjeheshe  
njëfarësoj gjithsesi.

Si në polenin e luleve,  
që spërkat gjithçka,  
diçka nga yllësi e nuševe  
mbi supe na ra.

Ti trim që rri në shkallë,  
pse rri i menduar,  
nëneja, që të ka djalë,  
s'të lë pa martuar...

Martesë shqiptare,  
dashuri e përgjithshme...  
Ikte vjeshta e dasmave,  
dimri i luftës vinte.

Sa shpejt nxihej ari  
mbi stolitë e nuseve,  
kur pas marsit të armëve,  
Vinte prilli i vejusheve.

Pastaj prapë vinte vjeshta,  
Krushqit, vallet, stolitë,  
dhe dhëndurët mes tyre  
si meteoritë.

Shumë e shumë është që  
dëshiron që sot ob i sëmundjeve

Unë mëson mësimin, unë mësoj mësimin

Unë mësoj mësimin, unë mësoj mësimin

... vërtet që përdorin  
... e shkrimtarët që e kishin  
... shtypur libra e besianës se vogël  
... që është i cili që

... e përdorin e përdorin  
... e përdorin e përdorin  
... e përdorin e përdorin  
... e përdorin e përdorin

## **SHPJEGIM PËR LIBRAT BESIANËS SE VOGËL**

... e përdorin e përdorin  
... e përdorin e përdorin  
... e përdorin e përdorin

Meqë ti do diçka të grisësh patjetër  
Në bibliotekën time,

Po të shpjegoj ç'ka këtu.  
Këto libra janë shkruar gjatë shumë e shumë  
vjetësh;  
Resht pas rreshti janë mbushur me a, i, u.

Ja për shembull ky këtu është xhaxha Homeri,  
Për gjithë ne shkrimtarët ky është babazot.  
Ku i ka sytë? Jo, s'ia ka ngrënë macja,  
Por, me sa duket, ajo ç'ka parë në botë.  
Ky mbi kalë është xhaxhi Don Kishoti, vërtet  
i marrë,

Po më vonë jam i sigurt se për të për të ti do të  
qash.

Kurse këta janë xhaxhi Migjeni me  
Naim Frashërin,  
Që nën jastëk besoj gjithmonë do t'i mbash.

(Sikur Zog e sulltan tē mos kishte atēherë  
Dhe nē vend tē tyre penicilinë tē kishte,  
Ata mē shumë do tē rronin dhe prej tyre sē paku  
Ca ditë mē tē bukura nē jetë ti do t'i kishe.

Por ti ngul këmbët se diçka, sidoqoftë duhet  
grisur,  
Në tē vërtetë çdo bibliotekë pér tē grisur ka  
diçka,  
Ja këtu nē qoshe rrinë grumbull ca poetë  
hermetikë,  
Më duket se njëfarësoj mund tē merresh me ta;  
Ndërsa ti sa vete rritesh e mëson fjalë,  
Ata bëjnë tē kundërtën, sa vete i harrojnë ato;  
Meqenësé tani pér tani ke moshën me ta pér t'u  
marrë,  
Unë hiqem mënjanë...  
dhe ti vepro!

## GJUHA SHQIPE

Kur në sulm hodhën turqit  
hordhitë e pambaruara,  
kështjellat e sintaksës  
s'i muar, që s'i muar.

Në bedena poemash  
popullore mbetën  
kuftoma divanesh e  
kuftoma bejtesh.

Kur panë se gjuhës  
s'i hodhën dot prangat,  
lëshuan drejt saj  
gjithfarë merimangash.

Parashtesa e pjesëza  
e lidhëza së prapthi,  
të bukurën gjuhë  
ta bënин lesharapi.

Në përcartje ta kthenin,  
në delir, në jerm.  
Ishin vite të rënda,  
Ishin shekuj plot helm.

Të të bënин ty, donin,  
Shqipëri, memece.  
Po ja, erdhi Naimi,  
si yll mbi ty ecte.

Dorën e zbehtë  
mbi ballë ta vuri,  
të të hiqte zjarrllëkun  
prej të sëmuri.

Dhe vdisnin pjesëzat,  
thaheshin merimangat,  
ndriste si perlat  
poezia e madhe.

Kjo gjuhë, që provoi  
Akrepat e shkretëtirës,  
ç'do të thotë përcartje  
e di, oh, e di mirë.

E di ç'do të thotë  
kllapi, hermetizëm,  
qoftë e ardhur nga Roma,  
qoftë nga Parisi.

Kjo gjuhë martire,  
lehonë e përjetshme,  
që lindi mes dhembjesh  
art të pavdekshëm.

REKUIEM PËR MAJAKOVSKIN

REKUIEM PËR MAJAKOVSKIN

## REKUIEM PËR MAJAKOVSKIN

REKUIEM PËR MAJAKOVSKIN

Kam ngrënë në një tryezë me vrasësit e tij  
në shtëpinë e pushimit të shkrimtarëve  
në Dubulti, në Jaltë.  
Buzëqeshnin dhe flisnin për realizmin  
socialist,  
ndërsa gjaku i tij  
skuqte mbi xhamat e makinave,  
mbi xhaketat, karriget, rrogat e tyre,  
mbi fytyrën kúqaloshe të Jermillovit kritik.

I binin gjoksit dhe flisnin për realizmin  
socialist  
në presidiume me stof të kuq,  
nën emblema me yll,  
ndërsa atë  
shtrirë gjërë e gjatë në tokën e zezë  
dimri rus e ngrinte,  
për ta shkrirë në prill.  
Forcë e errët e vëshur me rrobe socialiste,

turmë kritikësh xhuxhë, spekulantë,  
karrieristë  
sulmonin në marshin shekullor të mediokërve;  
«Ti ishe i madh, po ne ta hëngrem kokën».

Po ja, bronzi i tij në sheshin Majakovski  
u ngrit dhe i vrenjtur vështroi vitet që vinin.  
Pas turmës së vrasësve që i njinte, ai pa  
si retë e para të kundërrevolucionit nxinin.

Dhe poenia ime këshia le të mbretet  
e rrënum me skein.

Ky është kuptimi i kësaj poesie

që poeziat e kritikëve  
në këtë raste kanë përfunduar

Shkallur poezi i shqipërisë  
dhe këtij vjeti është e përgjithshme  
në Shqipëri. Në këtë vjet  
poemët e poetëve të rinj  
janë më shumë se që  
në vjetet e kaluar.

Izvorët e këtyre poemave  
janë vlerat e vjetra  
që kanë qenë e rëndësishme  
në historinë e Shqipërisë.  
Poemët e këtij vjeti  
janë tërësisht të lirë  
në vlerat e vjetra.

## NJË POEMË E PAMBARUAR PËR SHEKULLIN

Shekulli XX,  
shekull i shpejtësisë,  
me fuqi të tmerrshme ti gjérat i vjetëron,  
s'kaluan ca vjet, për ty nisa një poemë  
dhe erdh koha që poemës t'i bëj remont.

Kryqet mbi strofat dhe vargjet e shuara  
duken si skelat rrötull ndërtesës në punime.  
Zhvidhos vargje dhe strofa të tëra,  
i flak  
dhe ato bien me pluhur e rrapëllimë.

Kështu dhe ti, shekulli im,  
botës së tërë do t'i bësh remont.  
Unë zhvidhos vargje,  
ti regjime dhe qeverira,  
me vinçat e revolucioneve i ngre,  
mbi gërmadhat e zeza, mbi shkatërrinat,  
me kujë i flak përgjithnjë.

Shekulli XX,  
qeverira, ultimatumë, traktate, tension,  
mbështjellë me rripa makinash,  
gjyryk vigan i historisë,  
tym e avull nxjerr,  
vërshëllen e gjëmon.

Si një bari me katër krraba në duar  
në horizontet e botës qëndron,  
ti, që midis njëzet shekujsh detarë,  
për botën do të jesh shekulli Kolomb.

Dhe poema ime kështu le të mbetet  
e rrrethuar me skela,  
gjithmonë në remont,  
në pritje që ti, qindvjeçari i popujve  
të mbarosh, sic fillove,  
me revolucion.

Shenja ne kryeq

golani përfundimisht s'kupte  
dëshmi që kati e është përfundim  
dëshmi që kati e është përfundim  
dëshmi që kati e është përfundim  
dëshmi që kati e është përfundim

tsuh është përfundim e përfundim

gjithçka dëshmi që kati e është përfundim

**NJE PAMJE DIMRI**

Dhe poezi i kësaj kohë

Dimri mjegullat solli që larg  
dhe karvane me re të zëza.

Vetëtimat mbi shpinat e tyre  
si motive përmbi velenxa.

Dhe i shkundi retë me gjithçka,  
mbi qytetin e madh, mbi të dielën,  
sipër vinçash, tarracash të mëdha  
e mbi salsa koncertesh, para dyerve.

Ranë reflekset e tyre, pa shih,  
n'udhëkryqe midis kalimtarëve,  
ku veturnat shpejtonin në shi  
për në darkën qeveritare.

Në hyrje hotelesh e kinemash  
e gëzueshme gjithçka ish matanë,  
ndërsa lart mbi qytetin e madh  
Ecnin retë me motivet kuksjane.

Partisë sime është një vepër poetike e shumëpjesëshe e konsideruar si një monument i vërtetë i kultivimit të kulturës shqiptare. Në këtë vepër, poezi i këtij kohë, që ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë, ka qenë e përgjithshëm e rëndësishme.

Veprën e këtij vepër, që ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë, ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë. Në këtë vepër, poezi i këtij kohë, që ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë, ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë.

## SHËNIME

Partisë sime

Tema e Partisë është trajtuar në plan të gjërë historik në disa vepra poetike të Ismail Kadares, si te poemat «Shqiponjat fluturojnë lart» (1966) dhe «Vitet gjashtëdhjetë» (1969). Edhe në këtë vjeshtë ndihet krenaria e poetit për Partinë së cilës ai i këndon plot dashuri dhe me entuziazëm.

Statuja pa krahë

1. Të vihet re personifikimi i goditur mbi të cilin është ndërtuar poezia.
2. Ideja kryesore që e përshkon këtë poezi mund të përmblidhet me pak fjalë: rrebeschët e kohëve që kanë kaluar mbi truallin shqiptar nuk kanë mundur ta gërryejnë kulturën e vjetër të popullit tonë. Statujat pa krahë nga njëra anë shprehin madhështinë dhe forcën shpirtërore.

të shqiptarit, nga ana tjetër janë një aktakuzë ndaj të gjithë pushtuesve të shumtë të popullit tonë, që kanë dashur të fshijnë nga toka traditat, kulturën dhe vetë emrin e shqiptarit.

### *Ikja e Moisi Golemit*

1. Vjersha është e mbushur me antiteza, krahasime dhe analiza psikologjike shumë shprehëse dhe me bukuri artistike.

2. Shkrimtari jep me një gjuhë të pasur poetike rrugën e shëmtuar të tradhtisë. Veprën e gjeneralit ai e vë në një sfond të zi, si vetë vepra që ka ndërmarrë:

Kjo rruga përdridhet,  
si gjarpër i zi.  
Për ku po vrapon,  
gjeneral Moisi?

Krahasimi i kësaj rruge me gjarpérin e zi është më se i kuptueshëm, i qartë dhe i plotë. Kjo veper, të cilën ka ndërmarrë Moisi, është e rëndë, e shëmtuar si rruga me shumë pluhur, por kjo vepër pluhurin e saj e lë pas. Pra, tradhtia mbetet njollë e pashlyeshme. Tradhtia është sa e shëmtuar dhe e zezë, aq dhe e pandreqshme.

### *Balada e zhvarrimit*

Dihet historikisht, se kur vdiq Skënderbeu, hero ynë legjendar, turqit u sulën për të gjetur varrin e tij dhe, pasi e gjetën atë, eshtrat ia nxo-

rën jashtë dhe i varën në qafë si hajmali. Poeti, duke na dhënë një veprim të tillë të armikut, ka për qëllim të japë frikën dhe tmerrin që u kish kallur Skënderbeu turqve në betejat që patën me këtë kryetrim.

Tingëlli mi aktual, që ka kjo poezi, duket qartë në tërë strofat e saj, të cilat me figura të shndritshme, që janë sa madhore, aq dhe tokësore kanë për qëllim që ta bëjnë heroin të pavdekshëm, por në të njëjtën kohë dhe të mos e paraqitin atë qiller e mistik.

Trimi nuk ka vdekur dhe kurrë nuk do të vdesë. Vepra e tij ka frymëzuar e do të frymëzojë breza të tërë. Motivet dhe përshkrimet epike i japid forcë tërë poezisë, e bëjnë atë një tërësi unike. Shfrytëzimi më mjeshtëri i traditës së letërsisë së kaluar dhe i krijimtarisë popullore është një meritë tjeter, që vihet re në këtë vjershë. Përmasat që i jep poeti trimit janë marrë nga përmasat që iu jep populli trimave të Jutbinës, Mujit, Halilit dhe që gjenden dendur në eposin e kreshnikëve.

### Kënga e millionait

Mprehtësia e shkrimtarit në zbulimin e shfaqjeve dhe të dukurive të botës së vjetër bën që ajo të kapë çaste interesante të jetës. Shkrimtari në këtë vjershë ngrë problemin e martesës dhe të krijimit të familjes së re socialiste në kundërshtim me martesën e vjetër, që bëhej me mblesëri. Vjersha na njeh pak a shumë me një dashuri të

parealizuar, sepse vajza që do mullixhiu, martohet me një tjetër, atje ku e kanë fejuar dhe ky veprim është brenda normave të zakonit e të moralit të kohës. Autori e përgatit lexuesin për një luftë të re, që duhej të bëhej dhe u bë kundër këtyre prangave mesjetare, të cilat kanë ngelur në ndërgjegjen e njerëzve.

Vjersha shquhet për pasqyrimin e ndjenjave të holla të millionait, ajo e tregon atë të gjiltër si vetë mielli që bluan, dashuria e tij është e bardhë dhe e brishtë.

### *S'lindëm ne princa*

Është një ndër poemat e hershme të poetit, bo-tuar në vitin 1961 në vëllimin «Shekulli im». Në këtë poemë, si dhe në poemat e tjera që e pasuan, si «Endërr industriale», «Vdekja e turistikës», që erdhën dhe u ngritën më vonë në vepra me përmasa të gjera epike, si poemat e njobura «Për-se mendohen këto male», «Shqiponjat fluturojnë lart» etj., filloj të spikatë talenti i poetit tonë të njobur.

Që në këtë poemë të hershme filloj të duket prirja e poetit për thurje tablosh të gjera epike në përshkrimin e ngjarjeve, fakteve dhe epokave historike. Krahas gjerësisë tematike, në krijimet e autorit të ri u duk edhe aftësia e tij për të ngritur në art problemet e mprehta politike të kohës.

Poema «S'lindëm ne princa» tingëllon si një himn kushtuar brezit të ri, që shemb të vjetërën dhe ndëronton të renë, që lufton me një heroizëm të

paparë përmata spastruar këtë planet nga prangat, superfuqitë, poshtërimi i dinjitetit njerëzor dhe kombëtar të njerëzve.

Poema përmban në vetvete nota të fuqishme të një poezie antimilitariste, ajo tingëllon si akuzë e fuqishme kundër shtypjes dhe dhunës nga superfuqitë dhe të gjitha shtetet e tjera imperialiste, shtypëse dhe shfrytëzuese.

Nëpër faqet e kësaj poème të shkruat me pathos dhe frymëzim rinor ngrihet lart roli i madh i Partisë në farkëtimin e njeriut të ri, në shembjen e botës së vjetër, në lindjen e bindjeve dhe koncepteve të reja revolucionare, gjë që përbën edhe boshtin ideor të veprës.

### Kitaristi

Vjersha i kushtohet misionit dhe rolit të madh të artit në shoqëri. Ideja kryesore e vjershës është se arti gjithmonë lind përmes një pune të madhe, përmes gëzimeve dhe vuajtjeve të artistit së bashku me njerëzit, me shoqërinë dhe se arti i madh ngjizet gjithmonë në vlagën e punëve të mëdha e të dobishme shoqërore.

### Lokomotiva

Poemthi është ndërtuar mbi bazë të një personifikimi të goditur artistik, siç është lokomotiva, që mishëron luftën e egër grabitqare imperialiste.

Edhe kjo vepër dallohet për frymën e qartë antiimperialiste.

### *Shoqes që u martua*

Poezia ka përbajtje shoqërore dhe është drejtuar kundër zakonit prapanik të martesës me shkuesi. Autori shtjellon idenë e njohur dhe të stigmatizuar nga Partia, se lufta kundër zakoneve të urryera të së kaluarës kërkon mprehjen e vijgilencës, pasi bartësit e kësaj të keqe shoqërore, po të mos luftohen deri në fund, ndryshojnë pamjen dhe ngjyrat, por jo përbajtjen.

### *Fillrojtësi*

Kjo vjershë e ndier, plot lirizëm e ndjenja të ngrohta dashurie, i kushtohet heroizmit të njeriut të thjeshtë të punës. Ajo është ndërtuar në formën e një dialogu të brendshëm ndërmjet poetit dhe heroit të vjershës.

### *Kali i Trojës*

Lindjen dhe ardhjen në pushtet të revizionizmit modern, poeti e jep bukur me një paralelizëm figurativ, duke e krahasuar ose përngaçuar atë me kalin e Trojës. Revizionizmi erdhi me bujë e zhurmë për të molepsur masat e gjera punonjëse. Ai, si shprehje e interesave të borgjezisë

dhe të ideologjisë së saj, i mohoi qëllimet dhe fitoret e revolucionit, duke mashtruar me frazeologji boshe, duke pasur në thelbin e vet dramën e madhe të restaurimit të kapitalizmit në shumë vende të botës.

### *Topat e vjetër të Durrësit*

Me një detaj shprehës artistik, siç është ai i topave të qeverisë trädhtare të Ahmet Zogut, i cili përgatiti jo vetëm heshtjen e tyre, por u hapi edhe dyert fashistëve italianë, poeti me pak vizatime jep fundin e merituar të tradhëtisë dhe të turpit.

### *Ajte larg, në Veri*

Vjershë lakonike për trimërinë dhe heroizmin e vëllezërve kosovarë në përgjithësi dhe të Gjakovës në veçanti.

### *Motive me diell*

Një çast në licejt e Lurës i kapur nga poeti, sikur ta ketë futur në objektivin e aparatit fotografik. Dielli po perëndon dhe poeti do të kapë çdo gjë të ndritshme e të bukur, që është në anti-tezë me natën, që po shtrihet përreth. Nga kjo vjershë e shkurtër ka lindur më vonë edhe titulli i vëllimit «Motive me diell».

## *Fund vjeshte*

Një peizazh me ngjyra të kthjellëta dhe në të njëjtën kohë një lirikë e ndier dashurie.

## *Epitaf për aviatorin Niko Hoxha*

Vjersha është një lirikë e ngrohtë dashurie dhe respekti për heroin aviator, që ra në krye të detyrës.

## *Motive për elektrifikimin e përgjithshëm të*

### *Shqipërisë*

Ky cikël vjershash, që i lidh një bosht i vetëm, trajton temën e rëndësishme për rolin e madh të elektrifikimit të përgjithshëm në jetën e vendit tonë. Antiteza ndërmjet kohës obëkurantiste të satrapit Ahmet Zogu dhe kohës së lavdishme të Partisë, plot drithë, përparim e kulturë, antitezë pak që është krijuar përmes vargut të njojur «Pak drithë, pak drithë...» — e bën poezinë të ndier dhe poshtë me vargun «pjessët e zymta të Shekspirit» dhe drithës elektrike, që hapi sytë e njerëzve dhë ndriçoi mendjet e tyre.

## *Vallja shqiptare*

Vallja shqiptare, një nga llojet më të dashura të artit tonë popullor, shprehje e koncentruar e ndjenjave të zjarrta, e krenarisë dhe e trimërisë së

popullit tonë, ka mbartur mbi shpatullat e saj kohën, historinë dhe ka ardhur gjer te ne e bukur dhe e pastër, si vetë shpirti i shqiptarit. Qëndresa dhe madhështia e shqiptarit në tallazet e kohërave, vjen e qetë siç thotë poeti «me qetësi dhe madhështi» gjer sa merr zjarr në vargjet:

Ju bubullima me opinga  
që nëpër shekuj bridhni larg

Në këtë poezi poeti shtjellon idenë e gjenialitetit të artit popullor. Poezia ka në të njëjtën kohë një vlerë të veçantë politike dhe me përbajtjen e saj është një demaskim i të gjithë deviatorëve dhe mohuesve të vlerave të artit popullor, si Fadil Paçrami e të tjerë, që u përpoqën ta vënë kulturën dhe artin tonë në shërbim të artit dekadent borgjezo-revizionist, duke u nënështruar në mënyrë të verbër përpara çdo gjëje perëndimore dhe duke mohuar vlerat tradicionale të kulturës dhe të artit tonë kombëtar.

### Koha e popujve

Në këtë vjershë të mbështetur mbi një paralellizëm figurativ ndërmjet «superkafshëve» dhe superheteteve përçohet ideja e njohur marksiste se njeriu, shoqëria, popujt, janë forca kryesore lëvizëse e historisë dhe janë pikërisht këto forca që përcaktojnë rrugët e zhvillimit dhe jo «teknika» apo armët, siç propagandojnë teoricienët borgjezo-revizionistë.

Koha në të cilën ne jetojmë është e mbarësuar me revolucionare dhe me luftërat e shumta që kishin ndarë të popujve. Në këto luftërat superfuqive u rrëshqet toka nën këmbë. Kjo është rrjedha e historisë, ky është fundi llogjik i tyre. Popujt qëndrojnë të palëkundur në të drejtën e tyre dhe supershtetet përpeliten më kot të dalën nga bataku ku i ka çuar rruga pa krye në të cilën ata ecin. Poeti i krahason supershtetet me kafshët prehistorike që ngeçnin nga superpesha në batak. Në nëntekstin e saj të thellë dhe të mprehtë poezia ka qëndrimin heroik të Partisë dhe të popullit tonë përballë rrëbeshevë të kohëve, përballë blokadës së egër imperialisto-revisioniste.

### Lulemollët

Edhe kjo vjershë është ndërtuar mbi bazën e një antiteze shprehëse, jetës sónë të bukur e të gëzuar dhe vanitetit të jetës borgjeze.

Burim i të gjitha të mirave në jetën e njerëzve tanë është puna. Puna vetmohuese e popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë e bëri jetën e tij të lumtur e të begatshme. Ne jemi i vetmi vend në botë që ndërtojmë socializmin duke u mbështetur në forcat tona. Për këtë poeti thotë:

N'Evropë jemi vendi i vetëm,  
që në mbrëmje, më parë se gjithçka  
japim lajmet për njerëzit e thjeshtë  
të uzinave dhe fushave të mëdha.

Para kësaj jete, ish zotërinjtë, që presin t'u vijë koha e perënduar dh ee varròsur nga revolucioni, shtrembërojnë turinjtë dhe përbuzin lajmet nga fshati.

Romançizmi që përshkon vjershën nuk është idilik, ai është romantizmi i njerëzve tanë të punës dhe të luftës.

### *Alpet në dhjetor*

Bukurinë dhe madhështinë e maleve tona poeti nuk e sheh kurrë të shkëputur nga njerëzit që jetojnë në to. Në male janë shkruar legjendat për të mos rënë kurrë në duart e armiqve. Në këto male gjetën forcën e tyre heronjtë e legjendave, Muji dhe Halili. Edhe kur përshkruan natyrën poeti kur nuk largohet nga qëndresa e shqiptarit. Jeta e tij nuk ka kuptim pa këto male të larta. Por, në këta male ruhen edhe të gjitha dramat që ka kaluar shqiptari në shekuj. Metafora e përgjithshme që përdor poeti është se shqiptari dhe malet janë të lidhur me njeri-tjetrin si mishi me kockën.

### *Mësueset e fshatit*

Në këtë vjershë poeti nuk iu këndon mësueseve të fshatit si në një himnizim, duke vajtur vetura e duke i marrë ato te dera e shkollës. Përkundrazi, mësueset e fshatit janë të thjeshta e pa pretendime, ato kryejnë detyrën aty ku e kërkon atdheu dhe socializmi.

## *Portreti i Skënderbeut*

Figura e heroit tonë legjendar Skënderbeut skalitet me bukuri dhe madhështi. Emri i tij është edhe «dill» edhe «hënë». Por, në të njëjtën kohë është edhe njerëzor. Poeti i shmanget përshkrimeve hiperbolike, kështuqë vjersha fiton forcë bindëse artistike. Bukurinë dhe madhështinë e heroit e japid në mënyrë mjaft të ngjeshur artistike dy vargjet e fundit:

Gjithçka të shumtë ai e pati,  
të vetmen kish veç Shqipërinë.

Këtej del burimi i forcës dhe i trimërisë së Skënderbeut. Dashuria për atdheun është burim i pashtershëm i të gjitha virtyteve të Skënderbeut.

## *Nisja e shqiptarëve në luftë*

Historia i ka diktuar popullit tonë qenien e tij vetëm përmes luftës dhe ajo si e tillë është bërë pjesë e pandarë e jetës së tij. Shqiptari nuk nisej në luftë me zhurmë e bujë, por thjeshtë, me armët ngjeshur dhe me idealin e lirisë në gjit. Gjatë gjithë jetës së tij shqiptari u ndesh me armiq të shumtë, njeri më i egër se tjetri, por lirinë askush s'ia rrëmbreu, atë e ruajti me gjakun dhe jetën e tij.

Qëllimi i poetit është të nxjerrë qëndresën shekullore të popullit tonë, që e gjemë në tërë poezinë e Kadaresë. Për shqiptarin si nisja për luftë,

ashtu dhe kthimi janë njëloj të thjeshta. Poeti nënvizon idenë se shqiptari e ka vdekjen siç thotë populli «sikur me le» kur bie në fushën e nderit për mbrojtjen e atdheut, të nderit dhe të dinjitetit të tij.

### *Poetret malësori të hershëm*

Malësorët tanë trima dhe krenarë, të rritur në male dhe pranë malesh, gjithnjë me armën ngjeshur ecën nëpër kohëra dhe i bënë ballë historisë me të gjitha rrëbeshet e saj. Sinjali i alarmit për mbrojtjen e atdheut i zbret ata si vetëtimë që nga malet, që të mos shkelë kurrë këmbë armiku, ata zbresin në log të kuvendit për besë, liri dhe fitore dhe, po këshfu shkojnë krenarë drejt vdekjes:

Në brez armën mbushur,  
në kokë të zbrazëtin qefin

ose më poshtë:

Në brez vdekjen e tjetrit,  
në ballë vdekjen e vet.

Për shqiptarin vajta në luftë apo rënia në fushën e betejës është nderi dhe lavdia më e madhe, sepse ai lufton për vatanin e vet. Por lufta ka dhe humbje: do të vrasësh dhe do të vrash. Ky është poetizimi më real i luftës që poeti na e thotë qart, pa e fetishizuar as malësorin, as dhe

trimëritë e tij, duke na thënë. Vargjet e thjeshta e pa mbingarkesë emocionale e jadin më se të qartë portretin e malësorit shqiptar.

### *Nuset dhe dasmat*

Poezi me një shtrirje të gjerë tematike. Zakenet, kanunet që e ndrydhnin energjinë e gruas shqiptare dhe, në krahun tjetër — luftërat, pjesë e pandarë e jetës së shqiptarit, që kohët ia vunë mbi shpatulla.

Ikte vjeshta e dasmave,  
dimri i luftës vinte.

Kjo antitezë jep në thelb vetë jetën e shqiptarit, historinë e tij, nga njeri krah dashurinë për familjen (që shprehet përmes dasmave) dhe, nga ana tjetër urrejtjen për dhunën, që jepet përmes luftës së tij kundër armikut.

### *Shpjegim për librat e Besianës së vogël*

Duke iu drejtuar Besianës së vogël, që si të gjithë fëmijët e tjerë ka dëshirë të lozë e të grisë fletët e librave, poeti stigmatizon boshllëkun e artit dekadent borgjez e revisionist. Informacioni që jep vjersha është shumë i madh, këshillat që i drejtohen vajzës së vogël të bëjnë të mendosh. Poeti flet me admirim për kollosët e letërsisë botërore, si: Homeri, Servantesi e shkrimtarë tanë të mëdhenj si Naimi e Migjeni etj.

Seleksionimi që bën vajza e vogëlështë më se i domosdoshëm dhe bibliotekat duhen pastruar, siç thotë poeti:

Por ti ngul këmbë, se diçka duhet grisur,  
në të vërtetë çdo bibliotekë për të grisur  
ka diçka.

Ja këtu në qoshe rrinë grumbull ca poetë  
hermetikë,  
më duket se njëfarësoj mund të merresh me ta.  
Ndërsa ti sa vete rritesh e mëson fjalë,  
ata bëjnë të kundërtën, sa vetë i harrojnë ato.  
Meqenëse tani për tani ke moshën me ta  
për tu marrë,  
unë hiqem mënjanë...  
dhe ti vepro!

Poeti nuk duron që artit tonë të bukur të realizmit socialist t'i ngjiten si vemja izmat e artit borgjez e revizionist. Ai flet për një rini të shëndetshme artistikisht dhe estetikisht, për poetë e artistë të ardhshëm pa kurrfarë ndikimi nga pluhurat e borgjezisë dhe të revizionizmit.

### *Rekuiem për Majakovskin*

Vjersha ngre lart figurën e poetit të madh proletar Majakovskit dhe godet artin dekadent revisionist, që mbështetet në formalizmin dhe në të gjitha artificialitetet e tjera artistike.